

VENDIM
Nr. 318, datë 16.5.2012

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, PËR ÇËSHTJEN NR. 9074/07 “MULLAI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit nr. 9074/07, datë 18.10.2011 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen “Mullai dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në shumën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro në favor të ankuesve Mullai etj. dhe 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) euro në favor të shoqërisë “Teknoproject” sh.p.k., plus çdo tatim që mund të vendoset.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Vlefshmëria e lejes së ndërtimit nr. 766, datë 22.12.1998 të Bashkisë Tiranë, të zgjatet edhe për dy vjet, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe të garantojë kryerjen e pandërprerë të punimeve të ndërtimit gjatë kësaj periudhe.

4. Shuma prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) eurosh, e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve: znj.Nesime Mullai, z.Astrit Daci, znj.Mediha Hoti, znj.Suzana Zereliu, znj.Nermin Daci, znj.Etleva Mullai dhe znj.Eva Pinguli, kurse shuma prej 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) eurosh të depozitohet në emër të shoqërisë “Teknoproject” sh.p.k. dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma në datën e çeljes së llogarisë.

5. Pagimi i shumës, sipas pikës 4 të këtij vendimi, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda datës 18 maj 2012. Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marxhinal të huas së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha